REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 128/22
Datë/Datum 16.05.22
PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
Shqipe Hoti	*06.05.2022*	*16.05.2022*	128/2022

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.05.2022 OE "JAGUAR SECURITY"SHPK- Prizren, ka parashtruar ankesë me nr: 128/19, kundër njoftimit përmbi vendimin e autoriteti kontraktues të datës 04.05.2022 –Njoftim për anulim të aktiviteti të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi Fizik i Objekteve të MKK-së, me numër të prokurimit:2011-220-03-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria për Komunitetet dhe Kthim(në tekstin e më poshtëm MKK) .

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlere e mesme.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së,

Jo nuk është e përsëritur ankesa.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

1. Shkelje e nenit 7 te LPP-së
2. Shkelje e nenit 53 te LPP-së
3. Shkelje e nenit 62 te LPP-së
4. Shkelje e nenit 108/A të LPP-së

Shkelje e dispozitave të akteve nën ligjore sipas ankuesit:

1. Shkelje e nenit 25 i RRUOPP
2. Shkelje e nenit 44 i RRUOPP

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

Me disa plotësime, ku OE ankues ka sqaruar se ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK .

Së pari Autoriteti Kontraktues nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit me rastin e pranimit të kërkesave për rishqyrtim (si për rekomandim / dhënie të kontratës) ashtu edhe për (anulimin e aktivitetit të prokurimit), pra ka qenë i obliguar sipas Nenit 108/A paragrafi 2 i LPP-së. Poashtu Autoriteti Kontraktues me rastin e kthimit të përgjigjes (marrjes së vendimit) kundër kërkesës sonë për rishqyrtim, fare nuk iu është përgjigjur të gjitha pretendimeve tona ankimore të potencuara në ankesë, sepse sipas 'Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP-së dhe vlera e tarifave' është i obliguar të përgjigjet secilit pretendim ankimor. Aktiviteti i prokurimit në fjalë është anuluar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPPsë, saktësisht në kundërshtim me Nenin 62 (Përfundimi i aktivitetit të prokurimit). Ne jemi kundër këtij anulimit të aktivitetit, pasi që kontratën në fjalë edhe në vitet e shkuara e kanë ekzekutuar kompanitë tjera me të njëjtat terme e kushte pa asnjë problem, ju mund të verifikoni në platformën e e-prokurimit se ky aktivitet i prokurimit ka pasur të njëjtat specifika me vite të tëra, tani ndodh ndryshimi kur sipas mendimit tonë operatori i tyre shihet i favorizuar e nuk ka arritur të rekomandohet për kontratë sepse ka dal më i shtrenjt. Ne si kompani jemi në gjendje ta realizojmë kontratën me kushtet që janë parashtruar në dosjen e tenderit tek specifikimet teknike, dhe se nuk ka arsye për anulim të tenderit, nëse AK gjatë ekzekutimit të kontratës parasheh rritje apo zvogëlim të pikave të sigurimit mund të veproj konform Nenit 56.10 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ dhe jo ta anuloj pa bazë aktivitetin e prokurimit.

Me datën 27.04.2022 kompania jonë është rekomanduar për shpërblim me kontratë me anë të njoftimit mbi vendimin e AK-së të publikuar në platformën elektronike të eprokurimit. Është e padrejtë, e gabuar dhe duket shumë tendencioze mënyra e anulimit të aktivitetit të prokurimit përmes nxjerrjes së një njoftimi të ri mbi vendimin e AK të dërguar dhe publikuar në platformën e e-prokurimit me datë 04.05.2022. Arsyetimi i AK-së për anulimin e aktivitetit se: Pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim kemi vërejtur se specifikacioni nga njësia kërkuese ka paraparë katër (4) punëtor, kurse në orët e llogaritura dhe sipas Ligjit të punës për orët e punuara është konstatuar se këtë projekt duhet të jenë minimum pesë (5) punëtor. Andaj për shkak se duhet të ndryshohet dhe përmirësohet specifikacioni/lista e punëtorëve ka ardhur edhe deri tek anulimi i këtij aktiviteti, për të ri tenderuar procedurën për të cilën parashihet të jenë pesë (5) punëtor

Ky arsyetim është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së përkatësisht Nenit 62, dhe vendimi i ri i AK

shkel parimet e Nenit 7 të LPP-së (trajtimit të barabartë) pasi që na mohohet nënshkrimi i kontratës, pas një kërkese për rishqyrtim e cila nuk ka asnjë bazë ligjore për aprovim. Të gjithë operatorët ekonomik të cilët kanë shpreh interesim për këtë aktivitet të prokurimit kanë pasur kohë të mjaftueshme për të parashtruar kërkesa për informacione shtesë dhe atë deri më 14.04.2022 ora 16:00, dhe ofrimin e sqarimeve nga ana e Autoritetit Kontraktues, nëse ofertuesi i cili ka pasur dilema në numrin e punëtorëve "e që në specifikacionin teknik dhe dosjen e tenderit" kanë qenë mjaftë të kjarta numri i orëve që duhet realizuar, pikat vrojtuese (të ruajtjes me sigurim fizik), dhe numri i punëtorëve, atëher pse me kohë nuk ka parashtruar kërkesë për të sqaruar mirë këto informacione! Dispozitat ligjore Neni 18.4 (RRUOPP) thotë: Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratës në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasiqë dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor– të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë. Neni 53 (LPP) par.1 dhe par.4 dhe par.6 thotë: Par.1 Gjatë përgatitjes së tenderit, çdo operatorë ekonomik mund të bëjë kërkesë me shkrim te autoriteti përkatës kontraktues për çfarëdo informate apo sqarim shtesë që operatori ekonomik beson se është e nevojshme për përgatitjen ose dorëzimin e një tenderi përkatës, me kusht që çdo kërkesë e tillë me shkrim të pranohet nga autoriteti kontraktues Par.4 Autoriteti kontraktues menjëherë do të shqyrtojë çfarëdo kërkese të tillë për të përcaktuar nëse operatorët ekonomik kanë apo nuk kanë nevojë për informatat sqaruese ose plotësues të kërkuar në mënyrë që të përgatisin një tender të përgjegjshëm. Par.6 Nëse autoriteti kontraktues konstaton se ndonjëra nga informatat e kërkuara sqaruese ose plotësuese e cila kërkohet nga operatorët ekonomik për kontraktim është e domosdoshme për ta, autoriteti kontraktues menjëherë dhe në të njëjtën kohë siguron informata me shkrim, përmes mjeteve më të shpejta të mundshme, të gjithë operatorëve ekonomik, që kanë marrë ose kanë pranuar nga autoriteti kontraktues dosjen e tenderit përkatës ose ftesën për tenderim. Autoriteti kontraktues nuk do të zbulojë identitetin e operatorit ekonomik që i ka kërkuar informatat sqaruese. 7/9 Askund në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit nuk është përcaktuar që duhet të respektohet Ligji i Punës ashtu siç e keni potencuar në vendimin tuaj të ri, por ju e keni marr për bazë një kërkesë për rishqyrtim i cili ju ka lajthitur dhe keni rënë në kundërshtim me veten. Po të ishte cekur me kohë në njoftimin për kontratë dhe në specifikime teknike ashtu siç parashihet në dispozitën e mëposhtme ligjore atëherë natyrisht që edhe vlera e kontratës edhe numri i punëtorëve do të kishin ndryshuar, mirëpo ju nuk e keni paraparë! po ashtu edhe çmimet e ofertuesve do të ishin rritur dukshëm sepse nuk është vetëm se rritet numri i punëtorëve por kur përmendet Ligji i Punës do të kemi edhe shtesat e tjera të cilat i takojnë punëtorëve mbi pagën

bruto të cilën e pranojnë si: pagesa shtesë (30%) për orët e ndërrimit të natës, pagesa shtesë (50%) për orët e festave dhe vikendeve, pagesa e pushimit vjetor etj. 18.17 Autoritetet Kontraktuese mund të referohen në kushtet e përformancës së kontratës të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e punëtorëve dhe kushteve të punës të cilat janë në fuqi me ligj apo rregullore në Kosovë, me kusht që këto kushte të përfshihen në shpalljen e kontratës dhe në specifikimet teknike. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 47.24 Është bërë e qartë në nenin 56.3 të LPP, që tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe / ose në dosjen e tenderit. 49.19 Është bërë e qartë në nenin 56.3 të LPP-së, se një kandidat nuk do të diskualifikohet, përjashtohet, apo eliminohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kushti ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe / ose në dokumentin e para-kualifikimit. Pra nuk ka justifikim se njësia kërkuese ka gabuar dhe duhet përmirësohet specifikacioni, sepse ju nuk keni parashtruar kusht në dosjen e tenderit që të llogariten orët e punëtorëve sipas Ligjit të Punës apo të respektohet dispozitat ligjore të Ligjit të Punës, edhe pse kjo nuk është kompetencë e juaja por e Inspektoratit të Punës – MPMS të cilët janë po për këtë punë. Ne si kompani do ta realizonim këtë kontratë pa asnjë problem, duke siguruar objektin tuaj me dy pika ashtu siç është kërkuar dhe duke vendosur punëtorët e sigurimit në dy pikat sipas tabelës së dhënë në specifikacionin teknik (Aneks 1), një pikë 24h dhe një pikë 8h, kurse është në diskrecion të kompanisë respektimi i Ligjit të Punës dhe jo të AK-së, është e rëndësishme që ju të keni sigurim fizik në objekt ashtu siç keni kërkuar, kurse monitorimin e respektimit të ligjeve e bëjnë organet kompetente. Ju në objektin e Ministrisë keni pasur gjithmonë të njëjtin numër të punëtorëve dhe keni siguruar objektin gjithmonë po me këtë numër të punëtorëve dhe asnjëherë nuk keni pasur asnjë problem, andaj anulimi i këtij aktiviteti hedh dyshime se nuk keni arritur ta shpërbleni me kontratë operatorin tuaj të cilën tani më shihet se qenka i favorizuari juaj, mu për këtë nxjerrin vendim duke thënë se ka gabime në specifikacion e që asnjë gabim nuk shihet. Ju duhet ta keni parasysh se në specifikacion teknik e keni paraparë DEVIJIMIN prej +/- 30% e që edhe sipas dispozitave ligjore parashihet sipas Nenit 56.10 (RRUOPP), andaj përmes devijimit të lejuar mund të bëni ndryshime duke bërë kërkesa të tjera të cilat mund të zbatohen dhe jo të Anulohet aktiviteti i prokurimit. 8/9 Neni 44 (RRUOPP) par. 44.55 dhe par.45.6 thotë: Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: (i) asnjë tenderë nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar; (ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm; (iii) numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE - është më pak se 3; (iv) nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; (v) numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3; (vi) nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; (vii) asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm; (viii)

nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit; (ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi; (x) nëse AK gjate përgatitjes dhe udhëheqjes se procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i paripërueshëm; ose (xi) nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i paripërueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP. Pra asnjëra nga arsyet e lartcekura në dispozitat ligjore nuk është përdorur dhe arsyetuar për të anuluar aktivitetin e prokurimit, e hiq më pak është e pranueshme për arsyen e përdorur e cila nuk ishte paraparë në aktivitetin e prokurimit as në njoftimin për kontratë e as në dosjen e tenderit. Duke u mbështetur në këto të gjitha argumente dhe dispozita ligjore të lartpërmendura kërkojmë që ankesa jonë të APROVOHET si e BAZUAR dhe të anulohet vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe të vazhdohet me aktivitetin e prokurimit

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjn me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore).

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1.OE duhet te dëshmoj se ka përfunduar me sukses kontrate lidhur me shërbime te sigurimit apo te ngjashme realizuar ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimi. 1.Lista e kontratave te bashkangjitur me referenca. 2.Rojet e angazhuara duhet të jenë të licencuar me licence certifikate te vlefshme individuale të sigurimit themelor sipas nenit 14,20 dhe 27 të LSHPS 04 L-004. 2.Lista e punëtorëve të cilët do të angazhohen në këtë projekt , minimumi 4 , bashkangjitur licencën certifikatën e sigurimit për secilin punëtore, kontratat e punës.

Sigurimi fizik i objektit te MKK-se Sigurimi fizik i objektit te MKK-se 93000000-8 Kërkohet qe mbikëqyrja e objektit duhet te jete 24h pa ndërprerë, duhet te jenë te angazhuar 4 punëtore , gjate orarit te punës nga ora 8:00 deri 16:00 duhet te jene te angazhuar dy (2)punëtorë. Sipërfaqja e MKK-se e cila duhet te sigurohet, përfshinë hapësirat e objektit, parkingjet, shtigjet dhe sipërfaqet e gjelbëruara = 3,319.8 m² Kohëzgjatja Periudha Ore në muaj Ore ne vit Orët e nevojshme për sigurim fizik te objektit për një (1) vit (± 30% devijimi) 1 Roje 8:00 deri 16|:00 1 Roje16:00 deri 24:00 1 Roje 24:00 deri 8:00 (Nga e Hëna deri të Diellen) 24h 744 ore 8928 ore 1 Roje 8:00 deri 16|:00 Dite pune (Nga e Hëna deri të Premten) 8 h 168 ore 2016 ore Kontraktues, në objektin e MKK - së:

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

(Të përshkruhet vetëm vlërësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).
Ankesa është kundër Vendimit te AK-së Njoftim për anulim të aktiviteti të prokurimit

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).
N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).
N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).
N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "JAGUAR SECURITY"SHPK- Prizren

SQARIM :
Me datën 29.03.2022, për aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi Fizik i Objekteve të MKK-së, me numër të prokurimit:2011-220-03-2-2-1, AK ka publikuar Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit në fjalë hapja është bëre me datën:18.04.2022 ora 11:00h.

Me datën: 27.04.2022, AK ka publikuar Vendimin e tij - Njoftim për dhënie të kontratës ku i rekomanduar për dhënie të kontratës ka qenë OE "JAGUAR SECURITY"SHPK- Prizren, me çmim prej 13,570.56€.

Kundër vendimit te lartcekur operatoret ekonomik te pa kënaqur me ketë vendim të AK-së, brenda afatit ligjor kanë parashtruar kërkesën për rishqyrtim në AK.

Me datën 04.05.2022, AK merr vendim me të cilin aktivitetin e prokurimit në fjalë e anulon me arsyetim se "Ministria për Komunitete dhe Kthim anulon aktivitetin e prokurimit për arsye se pas pranimit te kërkesës për rishqyrtim kemi vërejtur se specifikojini nga njësia kërkues ko parapare katër(4) punëtore, kurse ne orët e llogaritura dhe sipas ligjit te punës për orët e punuara është konstatuara se ketë projekt duhet te jene minimumi pese (5) punëtore"

Me datën 04.05.2022, OE ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së -Njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit, kurse me datën 05.05.2022 OE ankues ka pranuar Vendimin e AK-së, për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Kundër vendimit datës : 05.05.2022 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, OE ankues me datën: 06.05.2022, parashtron ankesë në OSHP me numër të protokollit 128/2022.

Pretendimi Nr. 1: Lidhur me pretendimin e ankuesit se së pari Autoriteti Kontraktues nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit me rastin e pranimit të kërkesave për rishqyrtim (si për rekomandim / dhënie të kontratës) ashtu edhe për (anulimin e aktivitetit të prokurimit), pra ka qenë i obliguar sipas Nenit 108/A paragrafi 2 i LPP-së.

Përgjigje në pretendimin Nr. 1: Sqarojm, se në pajtim me nenin 6 ika 1 të ***Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave*** , AK është i obliguar që të veproj në ketë mënyrë me rastin e parashtrimit të një kërkesë për rishqyrtim: 6.1 Ushtrimi i kërkesës për rishqyrtim automatikisht pezullon procedurën e prokurimit dhe ne ketë rast Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, duhet te njoftoj me shkrim te gjitha palët e interesuara lidhur me pezullimin e procedurës së prokurimit në fjalë.

Pretendimi ankimore Nr. 2: Po ashtu Autoriteti Kontraktues me rastin e kthimit të përgjigjes (marrjes së vendimit) kundër kërkesës sonë për rishqyrtim, fare nuk iu është përgjigjur të gjitha pretendimeve tona ankimore të potencuar në ankesë, sepse sipas 'Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP-së dhe vlera e tarifave' është i obliguar të përgjigjet secilit pretendim ankimor.

Përgjigje në pretendimin Nr. 2: Për pretendimin e ankuesit sqarojmë se në pajtim me nenin 7 të ***Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave*** , refuzimi i një kërkesë për rishqyrtim duhet të arsyetohet nga AK si dhe në pajtim me nenin 8 pika 2 te ***Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave*** , AK është i obliguar qe për pretendimet e ankuesit te parashtruar ne kërkesën për rishqyrtim te merr vendim dhe te arsyetoj vendimin në fjale , sepse dispozita e lartcekur specifikon: 8.2. Vendimi i Autoritetit Kontraktues është i detyrueshëm për autoritetin kontraktuese dhe duhet të zbatohet menjëherë. Vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe ti komunikohet me shkrim, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Në rastet kur një zyrtar përgjegjës i prokurimit nuk lëshon një vendim ne lidhje me kërkesën për shqyrtim, Operatori Ekonomik ka te drejte qe te parashtroj një ankese pranë Organit Shqyrtues te Prokurimit. Me kërkesën e Organit Shqyrtues te Prokurimit, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik do te vazhdoj me procedurat e theksuara ne paragrafin 8 te nenit 25 te LPP-se.

Pretendimi ankimor Nr. 3: Aktiviteti i prokurimit në fjalë është anuluar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, saktësisht në kundërshtim me Nenin 62 (Përfundimi i aktivitetit të prokurimit). Ne jemi kundër këtij anulimit të aktivitetit, pasi që kontratën në fjalë edhe në vitet e shkuara e kanë ekzekutuar kompanitë tjera me të njëjtat terme e kushte pa asnjë problem, ju mund të verifikoni në platformën e e-prokurimit se ky aktivitet i prokurimit ka pasur të njëjtat specifika me vite të tëra, tani ndodh ndryshimi kur sipas mendimit tonë operatori i tyre shihet i favorizuar e nuk ka arritur të rekomandohet për kontratë sepse ka dal më i shtrenjt. Ne si kompani jemi në gjendje ta realizojmë kontratën me kushtet që janë parashtruar në dosjen e tenderit tek specifikimet teknike, dhe se nuk ka arsye për anulim të tenderit, nëse AK gjatë ekzekutimit të kontratës parasheh rritje apo zvogëlim të pikave të sigurimit mund të veproj konform Nenit 56.10 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ dhe jo ta anuloj pa bazë aktivitetin e prokurimit.

Përgjigje në Pretendimi Nr.3: Sqarojmë se neni 62 i LPP-së dhe neni 44 i RRUOPP, specifikojnë rastet kur një aktivitet i prokurimit mund te anulohet. Ne rastin konkret arsyeja e dhen nga AK për anulim të aktivitetit te prokurimit në fjalë nuk gjen mbështetje në dispozitat e cekura si më lart., sepse anulimi i aktivitetit te prokurimit pas hapjeve dhe vlerësimit te ofertave me arsyetimin se " Ministria për Komunitete dhe Kthim anulon3 aktivitetin e prokurimit për arsye se pas pranimit te kërkesës për rishqyrtim kemi vërejtur se specifikojini nga njësia kërkues ko parapare katër(4) punëtore, kurse ne orët e llogaritura dhe sipas ligjit te

punës për orët e punuara është konstatuara se ketë projekt duhet te jen minimumi pese (5) punëtore. Andaj për shkak se duhet te ndryshohet dhe përmirësohet specifikacioni/lista e punëtoreve ka ardhur edhe deri tek anulimi i këtij aktiviteti , për te ritenderuar procedurën për te cilën parashihet te jene pese(5) punëtorë", është në kundërshtim me nenin 7 dhe 62 te LPP-së.

Këtij arsyetimi i bashkëngjitet fakti se me datën 27.04.2022, AK ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e AK-se –ku është rekomanduar për dhënie te kontratës OE JAGUAR SECURITY"SHPK- Prizren, me çmim prej 13,570.56€.

Është e pa qartë si AK ka par, se dosja e tenderit duhet ndryshohet në ketë fazë kur ka bere vlerësimin e ofertave dhe ka rekomanduar për dhënie të kontratës një operatore ekonomi. Sqarojmë, se për kriteret e dosjes së tenderit janë faza tjera ku operatoret ekonomik mund të parashtrojnë kërkesat e tyre për rishqyrtim (kërkesë gjate periudhës kohore për sqarim të dosjes së tenderit apo kërkesë për rishqyrtim 5 dite para hapjes së ofertave në pajtim me nenin 108/A të LPP-së) për ndryshimet e kritereve të dosjes së tenderit. Pas kalimit te këtyre fazave për ankimim konsiderohet se ofertuesit janë pajtuar me kriteret e vendosura në dosjen e tenderit dhe ofertojnë në bazë të atyre kërkesave/kritereve të dosjes së tenderit te vendosura nga AK.

Sqarojmë se neni 44 paragrafi i 6 I RRRUOPP specifikon rastet kur mund te anulohet/përfundohet një aktivitet i prokurimit pas hapjes se ofertave ku: Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 99 (i) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK. Nga shkresat e lendes nuk është para ndonjë arsye e lartcekur nga AK e cekur si në ketë dispozita nga AK për anulim te aktiviteti te prokurimit në fjale andaj konstatojmë se anulimi i aktiviteti te prokurimit në fjale është bere në kundërshtim me nenin e lartcekur

Po ashtu edhe neni 62 i LPP-së specifikon:

2.Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit

kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Nga sqarimet e dhëna si me lart vijmë në përfundim se aktivitetit i prokurimit në fjalë në ketë faze është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 44 të RRUOPP.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet Vendimi i AK-së i datës: 04.05.2022- Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe aktiviteti i prokurimit në fjalë të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Ministria për Komunitetet dhe Kthim
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - JAGUAR SECURITY"SHPK- Prizren.